

Policia ndaloi ‘Range Rover-in’ për kontroll, 18-vjeçari nën pranga pasi u largua me vrap me një pistoletë

🕒 23/02/2023 10:08



Një 18 vjeçar është vënë në pranga në Lezhë pasi qarkullonte me armë zjarri me vete dhe tentoi të largohej me vrap për të shmangur kontrollin.

Policia ka ndaluar për kontroll automjetin tip “Range Rover”, me drejtues 18-vjeçarin K. L., dhe pasagjerë 25 vjeçarin J. K., dhe 17 vjeçarin L. K, të cilët janë në procedim penal.

18 vjeçari ka ndaluar makinën dhe ka tentuar të largohet me vrap duke marrë një çantë dore me vete. Policia e ka kapur dhe ndaluar drejtuesin e mjetit bashkë me çantën e dorës, ku u gjet një armë zjarri pistoletë dhe një krehër me 15 fishekë.

18 vjeçari u arrestua në flagrancë për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municioneve”, ndërsa dy pasagjerët janë në ndjekje penale për “Moskallëzim krimi”.

Sipas policisë materialet procedurale u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

“Lezhë/Falë inteligjencës policore, finalizohet operacioni i koduar “Ndërhyrja”. Qarkullonte me automjet dhe me armë zjarri me vete, tentoi të largohej me vrap për të shmangur kontrollin, vihet në pranga 18-vjeçari. Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë, me krehër me 15 fishekë. Procedohen në gjendje të lirë 2 shtetas (pasagjerët në automjet), për moskallëzim krimi. Gjatë operacionit, në Lezhë, shërbimet e Policisë kanë konstatuar dhe ndaluar për kontroll automjetin tip “Range Rover”, me drejtues shtetasin K. L. dhe pasagjerë shtetasit J. K. e L. K. Shtetasi K. L. ka ndaluar automjetin dhe ka tentuar të largohet me vrap, duke marrë dhe një çantë dore me vete. Shërbimet e Policisë kanë ndërrë menjëherë, duke e kapur dhe ndaluar shtetasin K. L., bashkë me çantën e dorës. Gjatë kontrollit në çantën e dorës, shërbimet e Policisë gjetën një armë zjarri pistoletë me një krehër me 15 fishekë, e cila u sekuestrua në cilësinë e proves materiale. Në përfundim të veprimeve u arrestua në flagrancë shtetasi K. L., 18 vjeç, banues në Lezhë, për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municioneve”. Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori dhe nisi procedimi në gjendje të lirë, për 2 pasagjerët në automjet, shtetasit J. K., 25 vjeç dhe L. K., 17 vjeç, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”. Materialet procedurale u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme”, sipas njoftimit të policisë.

Top Channel

I Aktualitet »



Lejonin kalimin e personave që s'mund të udhëtonin në zonën Shengen/ Lihen në burg 6 policët e portit të Durrësit

🕒 23/02 14:45




Vihen në pranga vëllezërit binjakë në Krujë/ Prodhonin dhe shpërndanin drogë në afërsi të shkollave dhe lokaleve

🕒 23/02 14:21



Në ndihmë të Turqisë dhe Sirisë/ Top Channel dhe Fundjavë Ndryshe nisin batanije dhe veshmbathje

🕒 23/02 14:11



Kontrolle në Vlorë/ Bie në pranga 29- vjeçari, shpallen në kërkim katër të tjerë, pjesë e grupit kriminal

🕒 23/02 13:19



Ndarja e rrugës së re “Miqësia” në Spitallë, banorët: Trafikndarësja po na lë pa punë

🕒 23/02 12:52



Lihen 60 ditë në burg “atentatorët”, u arrestuan pas parandalimit të vrasjes në Elbasan

🕒 23/02 12:23


Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ Katër të vdekur në një aksident në Kosovë, në gjendje të rëndë edhe një grua shtatzënë



Top News – Goditet grupi kriminal në Vlorë/ Me jelek antiplumb e municione luftarake



Top News – Italia e alarmuar nga luftanijet ruse!/ 15 anije dhe 3 nëndetëse në Mesdhe



Top News – ‘Vrasësit e kenianes në Qeveri’/ Berisha flet për dhunën ndaj Joy-t



Top Channel/ Balla merr fjalën, deputetët e PD-së qëndrojnë në këmbë rreth foltores



Top Channel/ Braçe mban fjalën nga vendi, deputetët u bien tavolinave

I Kryesore



Protestë para gjyqit të “vulës”/ PD më e qetë, kërkon të mos përjashtohen deputetët para përballjes me Ramën

🕒 14:55

Mungojnë bilbilat në seancë, demokratët i druhen përjashtimeve nga seanca e dy marsit

🕒 11:18

Goditet qendra e masazhit në Tiranë ku ushtrohej prostitucion, tre të punësuarë në pranga, një në kërkim

🕒 11:27

Lihen 60 ditë në burg “atentatorët”, u arrestuan pas parandalimit të vrasjes në Elbasan

🕒 12:23

Vuçiç jep ultimatum: Ose të formohet Asociacioni, ose...

🕒 12:24

I Më të lexuarat

“Rrëfejnë krimet”/ Zbardhen emrat e pesë bashkëpunëtorëve të drejtësisë

Top Story/ Dumani vrau 16 persona, Qyno: ‘Krimi’ pagoi 3 milionë euro për eliminimin e kundërshtarëve

Vrasja e shqiptarit në Mykonos, flet e dashura greke: Ai ishte si fëmijë, njihej me autorin

“Bankers Petroleum Albania” prodhoi rreth 540 mijë ton naftë në Patos-Marinëz gjatë 2022-shit

Vuçiç jep ultimatum: Ose të formohet Asociacioni, ose...

Seancë plenare dhe protestë/ Berisha dhe 7 deputetë të përjashtuar! Tentojnë të hynë në Parlament, demokratët bllokojnë foltoren

Po raportonte një skenë krimi, vritet gazetari, pas tij një 9-vjeçare në Florida

Meta në SPAK/ Qyno rrëfen si u ‘zbërthye’ nga drejtësia, ish-anëtar i LSI-së që denoncoi kryetarin e PL

Pse hesht Kastriot Ismailaj? Gazetari ngre pikëpyetje për njeriun e vetëm që bën burg për çështjen CEZ-DIA

Goditet qendra e masazhit në Tiranë ku ushtrohej prostitucion, tre të punësuarë në pranga, një në kërkim